

RAPORT VJETOR | 2017



i madh dhe i sigurt

www.insig.com.al

Shqipëri

Rruga “Jul Variboba” Nr. 21 ,

Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 42 400 792 ,

Fax: +35542400800 ,

E-mail: info@insig.com.al

Kosovë

Rr. “UÇK” Nr. 240, 10000

Prishtinë, Kosovë

Tel: + 383 38 249 900

Tel: + 383 46 100 055

E-Mail: info@insig-ks.com

Web: www.insig-ks.com

Raport vjetor

2017

Përmbajtja

Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm.....	5
Tregu i sigurimeve.....	6
Përgjegjësia sociale.....	7
Pronësia mbi kompaninë	9
Organizimi i Kompanisë.....	10
Organigrama.....	12
Treguesit financiarë.....	13
Dëmet të paguara.....	16
Opinion i audituesit të pavarur.....	17
Shënime mbi pasqyrat financiare	24
Treguesit e mjaftueshmerise se kapitalit, treguesit e likuiditetit dhe treguesit e aktiveve ne mbulim te provigjoneve teknike.....	25
Raport (Përmbledhje)	25

Miq dhe kllientë të INSIG, të nderuar lexues të raportit 2017!

Kam kënaqësinë që në pak rreshta të shpreh atë çfarë kompania INSIG sh.a, ka bërë përgjatë vitit 2017 në tregun e sigurimeve në Shqipëri. Nëpërmjet Raportit Vjetor të vitit që lamë pas, jam e lumtur që iu prezantoj arritjet e kompanisë INSIG, si dhe synimet e saj për vitin 2018, në një treg sigurimesh me rritje, me vështirësi dhe sfida, në një ekonomi kombëtare me jopak probleme.

Viti 2017 nuk kaloi pa sfida, mundime, punë të palodhshme, por i suksesshëm për shoqërinë INSIG sh.a në përmbushjen e angazhimeve. Eksperienca e fituar ndër vite e INSIG dhe forcimi i kompanisë në vitin e dytë të privatizimit nga grupi EURSIG, riktheu besimin e kllientëve e bashkëpunëtorëve, si dhe të të gjithë stafit, si në Drejtorinë e Përgjithshme, ashtu në degët në rrethe e deri te agjentët tanë.

Treguesit financiarë të kompanisë për vitin 2017, treguan se, INSIG ka ndryshuar strategjinë e punës me kllientët, duke arritur kështu dhe disa prej objektivave të saj, në lidhje me kapitalin, me treguesit financiarë dhe rritjen e prezencës në tregun e sigurimeve.

Statistikat financiare dëshmojnë më së miri se, INSIG sh.a, gjatë vitit 2017 pati rritje në tregun e sigurimeve të jojetës. Rritja e kompanisë në këtë treg tregoi përkushtimin dhe vlerësimin e kllientëve, ndërkohë që krahasuar me një vit më parë, INSIG nuk ishte më sigures i jetë dhe jojetë. Por, shoqëria u nda në dy kompani të ndryshme, të sigurimeve të Jojetës dhe Jetës dhe rritja në treg, e konsiderueshme, ka të bëjë vetëm me klasat e sigurimit të jojetës.

Shtimi i kllientëve, përkushtimi ndaj tyre, besnikëria e treguar dhe rritja e pagesave të dëmeve krahasuar me vitet e mëparshme të INSIG sh.a, bënë që primet të rriten në 14 për qind, me vlerë totale 1.086.699 mijë lekë dhe numri total i kontratave të rritej me 14%.

Jam krenare, që gjatë vitit 2017, kohë kur drejtova kompaninë INSIG sh.a., portofoli i fitimeve të kompanisë u rrit, ndërkohë që kemi sërish për të përmirësuar në raport me marrjen në sigurim, ndërsa cilësia e shërbimit ndaj kllientëve është sfida e përhershme jona.

INSIG zuri 7.2% të tregut të sigurimeve të jojetës për vitin 2017, ndërsa dëmet e paguara u rriten me 10.2%, ose 41.171 mijë lekë me shume.

Sigurimet vullnetare zunë 17% të primeve me vlerë 189.749 mijë lekë, ndërsa të detyrueshmet 83%, me vlerë 896.950 mijë lekë.

Këta tregues janë pasqyra e INSIG, rritjes së tij, duke shprehur më së miri rikthimin e besimit të kllientëve në emrin e madh, me sigurinë që ofron, ashtu siç është edhe slogani i shoqërisë së parë të sigurimeve në Shqipëri, "i madh dhe i sigurt".

Sfidat e INSIG gjatë viteve të tranzicionit në Shqipëri, nuk kanë qenë të vogla e të pakta në numër. Por, më lejoni të shpreh bindjen se, që pas privatizimi, INSIG po rifiton lavdinë, po rikthen besimin e kllientëve dhe e gjitha kjo, bazuar në përkushtimin maksimal dhe profesionalizimin e stafit, përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe shtimin e gamës së produkteve, paketeve, ofertave dhe shërbimeve. Mbi të gjitha, INSIG tashmë ka kapitalin e nevojshëm për të dëmshpërblyer atë që ne e kemi parësor dhe kryefjalë të punës tonë, kllientin.

Viti 2017 ishte i suksesshëm për INSIG, por i pamjaftueshëm. Që do të thotë se, viti 2018 e në vazhdim, do të sjellë për kompaninë suksese të tjera dhe më të mëdha, rritje në treg dhe krahas sfidave që na presin, INSIG do të jetë vetëm në ngjitje!

Singerisht dhe me konsideratë,
Venera XHILLARI
Drejtore e Përgjithshme e INSIG sh.a



Tregu i sigurimeve për vitin 2017

Gjatë vitit 2017 tregu i sigurimeve ka pasur një rritje prej 5.38%. Volumi i primeve të shkruara bruto është rritur me 826,038 mijë lekë duke arritur shifrën 16,193,678 mijë lekë.

Numri i kontratave arriti në 1,261,238 duke shënuar një rritje me 11.99% krahasuar me vitin 2016.

Volumi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jo-Jetës kapi shifrën 14,907,715 mijë lekë duke shënuar një rritje në masën 4.21% krahasuar me vitin 2016.

Numri i kontratave në sigurimin e Jo-Jetës kapi shifrën 1,087,274 duke shënuar një rritje në masën 7.38% krahasuar me vitin 2016.

Volumi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jetës kapi shifrën 1,204,267 mijë lekë duke shënuar një rritje në masën 23.15% krahasuar me vitin 2016.

Numri i kontratave në sigurimin e Jetës arriti në 173,917 duke shënuar një rritje në masën 53.08% krahasuar me vitin 2016.

Gjatë vitit 2017, janë paguar gjithsej 5,514,171 mijë lekë dëme ose 15.80% më shumë se gjatë vitit 2016.

Numri i dëmeve të paguara në vitin 2017 është rritur me 12,538 dhe arriti shifrën 43,954 nga të cilat 42,390 dëme janë paguar nga shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës dhe 1,564 nga shoqëritë e sigurimit të Jetës.



Përgjegjësia Sociale

Janar 2017

Z. Kadri Morinaj takohet në Baden Württemberg, me Ministrin e Drejtësisë së Kantonit dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Panairit Ndërkombëtar të Shtutgardit.

Shkurt 2017

Presidenti i Grupit EUROSIG, Z.Kadri Morinaj, takohet me trajnerin e kombëtares shqiptare Gianni De Biasi, i cili u vlerësua nga Italia me “Urdhrin e Yllit të Italisë”, që iu dorëzua nga ambasadori italian në Tiranë, Alberto Kutilo.

Mars 2018

Gjatë një vizite në Maqedoni, Presidenti i EUROSIG Group, takon Kryetarin e Bashkissë së Shkupit, Koçe Trajanovski. Z.Morinaj i tha kryebashkiakut se, zhvillimi dhe forcimi i biznesit mes dy vendeve, i largon popujt nga politikat nacionaliste.

Në ditën e Sulltan Novruzit, Kryegjyshata Botërore Bektashiane i i akordoi Presidentit të EUROSIG dhe INSIG, Z.Kadri Morinaj, çmimin “Kalorës i Artë i Ehlibetit”. Çmimi iu dorëzua nga Kryegjyshi Botëror, Dede Haxhi Edmond Ibrahimaj, me motivacionin, “si njeriu i suksesshëm i biznesit, familjarin e mrekullueshëm që me përlësinë e tij u shtrin dorën pa kursim njerëzve në nevojë”.

Z.Kadri Morinaj vlerësohet me titullin “Doctor Honoris Causa” nga Universiteti Amerikan UAC, School of Global Management dhe International Academy of Social Sciences me qendër në Florida, SHBA.

Prill 2017

Startup Grind është një komunitet global, i dizenuar për të edukuar dhe frymëzuar të rinjtë anembanë botës me anë të historive inspiruese të sipërmarrësve më të suksesshëm. Për këtë arsye, Z. Kadri Morinaj, ishte i ftuar si një frymëzim për të gjithë të rinjtë që duan të bëjnë pjesë në botën e sipërmarrjes.

Qershor 2017

Z. Kadri Morinaj mori pjesë në Ceremoninë e Diplomimit të studentëve të Fakultetit të Ekonomisë, në Nëntor të vitit 2016, i ofroi bursë të plotë për pagesën e shkollimit ekselentëve të këtij universiteti. Ndërsa në qershor 2017, Aurela Meçajt dhe Ina Shkullakut, studente ekselente, Z.Morinaj iu dorëzoi çeqet.

Z. Kadri Morinaj, Presidenti i EUROSIG-INSIG, bashkë me Bordin Drejtues Z.Vasil Pilo dhe Z. Rexhep Meidani, darkuan me Kryeministrin e Republikës së Maqedonisë Z.Zoran Zaev, në sofrën e iftarit të organizuar nga Oda Ekonomike e Maqedonisë Veri-Perendimore.

Tetor 2017

Presidenti i EUROSIG Z. Kadri Morinaj, kontribuo personalisht në hapjen e Ekspozitës së Pikturës “Albanian & German Colors”, nga artisti shqiptar Muhamet Kërpaçi dhe artisti shqiptaro-gjerman Z.Vullnet Muja.

Nëntor 2017

Presidenti i EUROSIG, Z.Kadri Morinaj, ishte i ftuar në lançimin e Masterit për Sigurime në Kolegji Universitar “Luarasi”, ku tregoi mbështetje jo vetëm për këtë universitet, por mundësoi

edhe 20 bursa për punonjësit e EUROSIG & INSIG.

Z.Kadri Morinaj, mori pjesë s'ii ftuar nga Shqipëria, si dhe një prej investorëve më të mëdhenj në Kosovë, në darkën me Presidentin e Kosovës, Z.Hashim Thaçi, në mbrëmjen Gala të Forumit Ekonomik të Diasporës Shqiptare në Prishtinë. Z.Morinaj ishte i ftuar dhe si një promovues i biznesit dhe vlerave shqiptare në botë.

Presidenti i EUROSIG dhe INSIG, Z.Kadri Morinaj, mirëpriti në një darkë Gala Forumin Ekonomik të Diasporës në Restorant "Piazza" në Tiranë, me rastin e 105-vjetorit të Pavarësisë.

Z. Kadri Morinaj pret në ambientet e EUROSIG, Presidentin e Nderit të Biznesmenëve Shqiptarë të Diasporës, Z.Lazim Destani, së bashku me një grup biznesmenësh shqiptarë në Diasporë.

Dhjetor 2017

Në Rio de Janeiro, kryeqytetin e Brazilit, u mbajt një meshë për nder të Z.Kadri Morinaj, i cilësuar si mik special i Papa Françeskut. Pas meshës së mbajtur nga Kardinali dhe Kryepeshkopi i Rios, ku mernte pjesë vetë Z.Morinaj, u zbulua dhe Pllakata e përgatitur në Brazil për në Statujën e Nënë Terezës, të mundësuar nga Presidenti i EUROSIG.

Z.Kadri Morinaj mori pjesë në Asamblenë Evropiane të Biznesit, në Samitin e Liderëve në Oxford, Angli. Në këtë aktivitet ndërkombëtar, Z.Morinaj mori çmimin "Sokrates", dhënë për Grupin EUROSIG, "Për arritje të jashtëzakonshme në fushën e biznesit"! Çmimi u dha nga Drejtori i Përgjithshëm i Europë Bussines Assambly ne Oxford, Profesor John Netting.



IV. PRONËSIA MBI KOMPANINË

Në përputhje me Statutin e kompanisë, Neni 6, kapitali themeltar ,pas ndarjes së aktivitetit në 01.01.2017 në INSIG Jetë dhe INSIG sh.a., është 650.000.000 lekë (gjashtëqind e pesëdhjetë milion), i ndarë në 1,083 (njëmijë e tetëdhjetë e tre) aksione, me vlerë nominale 600,184.67 lekë secili. Gjatë vitit 2016, aksionet e shoqërisë iu shitën në masën 100% shoqërisë së sigurimeve Eurosig sh.a.

Këshilli Mbikqyrës :

Vasil Pilo – Kryetar

Rexhep Mejdani – Anëtar

Thanas Xhillari – Anëtar




Organizimi i Kompanisë :

Rrjeti i Shpërndarjes së INSIG sh.a.
Degët dhe numri i punonjësve


2017 Nr. Mesatar i punonjësve të INSIG sh.a. QENDËR - 55

Shqipëri

	Gjendja 31.12.2017	
Nr.rendor	Degët / Agjensitë	Nr. i punonjësve
1	BERAT	5
2	DIBËR	3
3	DURRËS	4
4	ELBASAN	5
5	FIER	4
6	GJIROKASTËR	2
7	KAVAJË	2
8	KORCË	4
9	KUKËS	2
10	LAÇ	1
11	LEZHË	3
12	LUSHNJË	3
13	POGRADEC	4
14	SARANDË	3
15	SHKODËR	7
16	TIRANË 1	11
17	TIRANË 2	11
18	TIRANË 3	16
19	VLORË	7
	Total Degë/ Agjenci	97



Organigrama




VI. TREGUESIT FINANCIARË

AKTIVITETI SIGURUES

Në vitin 2017 u shkruan 1,086,216 mijë lekë prime nga sigurimet e jo-jetës.

Shpërndarja e primeve të shkruara bruto sipas linjave të biznesit për INSIG sh.a Shqiperi :

Lloji i produktit	viti 2017	viti 2016
Mjete motorrike	86 %	75 %
Pasuri	12 %	13 %
Jetë	-	11 %
Shëndet	2 %	1 %
Totali	100%	100%



DËME TË PAGUARA

Përgjatë vitit 2017 INSIG sh.a. u fokusua në përmirësimin e ndjeshëm të shërbimit ndaj klientit nëpërmjet procedurave më fleksibile dhe të shpejtë. Gjatë vitit 2017 vlera e dëmeve të paguara kapin shifrën prej 1,022,641,558 lekë.

Dëme të paguara në lekë (Grupi)	
2017	1,022,641,558 lekë
2016	758,846,396 lekë

OPINIONI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për aksionerët e INSIG sh.a

Opinion me rezerve

Ne kemi audituar pasqyrat financiare për qëllime të veçanta të INSIG sh.a (“Shoqëria”), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2017, pasqyrën fitimit ose humbjes dhe te ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në seksionin e raportit tonë Bazat për Opinionin me Rezervë, pasqyrat financiare individuale bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 dhjetor 2017, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me kërkesat e raportimit financiar për Shoqëritë e Sigurimit në Shqipëri.

Bazat për Opinionin me Rezervë

1. Sikurse është paraqitur në shënimin 2, *Bazat e përgatitjes*, dhe shënimin 18 *Marrëdhënie me Degën Insig sh.a Kosovë ('Dega')*, të pasqyrave financiare për qëllime të veçanta bashkëlidhur, Shoqëria nuk ka kryer kombinimin sipas secilës kategori të aktiveve dhe detyrimeve të saj si edhe kombinimin e të ardhurave dhe shpenzimeve me pasqyrat financiare të Degës së saj Insig Sh.a Kosovë. Marrëdhënia me Degën përfshin edhe fitimin e vitit të Degës në vlerën prej 122,352 mijë lek (2016 humbje 1,271,500 mijë Lek). Nëse Shoqëria do të kishte kryer kombinim për secilën kategori të aktiveve dhe detyrimeve të saj si edhe kombinimin e të ardhurave dhe shpenzimeve me pasqyrat financiare të Degës, fitimi i vitit do të rritej me fitimin e vitit të Degës, si dhe detyrimi për Marrëdhënie me Degën Insig sh.a Kosovë, i cili paraqitet në këto pasqyra si një zë i vetëm në bilanc, do të shpërndahej në vlerat përkatëse të secilës kategori të aktiveve dhe detyrimeve.
2. Siç është prezantuar në shënimin 16, *Aktive Afatgjata Materiale*, Shoqëria ka rivlerësuar vlerën e drejtë për disa ndërtesa në vitin 2017. Vlera kontabël e këtyre pronave më 31 dhjetor 2017 është 52,106 mijë Lek. Vlera e drejtë dhe e rikuperueshme e investimeve në ndërtesa dhe pasuri të paluajshme është përcaktuar nga një vlerësues i jashtëm pronash i cili ka përdorur metodën e krahasimit për vlerësimin e ndërtesave. Ne nuk mund të merrnim evidenca të përshtatshme dhe të mjaftueshme për tu mbështetur në vlerësimin me bazen e krahasueshmërisë të kryer nga Shoqëria për përcaktimin e vlerës së drejtë dhe të rikuperueshme të ndërtesave. Për me teper IAS 16 Aktivët Afatgjata Materiale kërkon që nëse një apo disa aktive rivlerësohen, e gjithë kategoria e aktivitet/aktiveve rivlerësohet. Shoqëria nuk ka rivlerësuar të gjithë kategorinë e ndërtesave. Si rrjedhim, ne nuk mund të merrnim sigurinë e mjaftueshme dhe të duhur për të përcaktuar nëse ka nevojë për rregullime në lidhje me vlerën e drejtë dhe vlerën e rikuperueshme të aktiveve afatgjata materiale në pasqyrën e pozicionit financiar të Shoqërisë si edhe për rezervën e rivlerësimit më 31 dhjetor 2017 dhe 2016.

3. Sikurse është paraqitur në anekset suplementare, Shoqëria ka llogaritur aftësinë paguese dhe aktivet e lejuara në mbulim të provigjioneve teknike. Më 31 dhjetor 2017, aftësia paguese duke përdorur metodën e kapitalit neto është në vlerën negative prej 995,728 mijë Lek krahasuar me vlerën prej 370,000 mijë Lek të kërkuar sipas ligjit 52 datë 22.05.2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu, aktivet e lejuara në mbulim të provigjioneve teknike me 31 dhjetor 2017 ishin 38,26% (2016 - 68%) e provigjioneve teknike bruto krahasuar me një minimum prej 100% të kërkuar nga i njëjti ligj. Më 31 dhjetor 2017, Shoqëria ka përfshirë humbjet e mbartura të degës Insig Kosova në llogaritjen e aftësisë paguese. Më 31 dhjetor 2017, Shoqëria nuk ka arkëtuar huanë nga Eurosig Sha si edhe ka rritur parapagimet ndaj pronarit (shënimi 12), gjë e cila, së bashku me humbjet e mbartura të degës Insig Kosova, ka ndikuar në përqesimin e treguesve rregullatorë. Rrethanat e përshkruara më sipër tregojnë ekzistencën e një pasigurie materiale që mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Shoqëria nuk ka njohur ndonjë provizion lidhur me ndëshkimet që mund të ndodhin sa i përket mospërputhjeve me kërkesat rregullatore të lartpërmendura.

Për shkak të efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafet e mësipërme ne nuk mund të përcaktojmë nëse rregullime në raportin e aktiveve për mbulim e detyrimeve të sigurimit do të ishin të nevojshme.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të).

Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare për Qëllime të Veçanta. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesioniste të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Etikave Standarde për Kontabilistët (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare për qëllime të veçanta në përputhje me kërkesat e raportimit financiar për Shoqëritë e Sigurimit në Shqipëri, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare për qëllime të veçanta që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare për qëllime të veçanta, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare për Qëllime të Veçanta

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare për qëllime të veçanta në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare për qëllime të veçanta.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare për qëllime të veçanta, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedurë auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontrolleve të brendshme.
- marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedurë të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontrolleve të brendshme të entitetit.
- konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare për qëllime të veçanta ose, nëse keto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga drejtimi, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne i identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Kuadri Kontabël dhe Kufizimi në Përdorim dhe Shpërndarje

Pa modifikuar opinionin tonë, ne tërheqim vëmendjen për Shënimin 2 të pasqyrave financiare për qëllime të veçanta, i cili përshkruan bazat e raportimit financiar. Këto pasqyra financiare për qëllime të veçanta janë përgatitur në mënyrë që Shoqëria të raportojë aktivitetin në territorin e Shqipërisë i cili është subjekt i supervizionimi të Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare në Shqipëri. Si rezultat i kësaj, pasqyrat financiare për qëllime të veçanta mund të mos jenë të përshtatshme për një qëllim tjetër. Raporti ynë është përgatitur vetëm për përdorim nga ana e Shoqërisë dhe Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare ("AMF") në Shqipëri, dhe nuk duhet të përdoret ose shpërndahet nga/në asnjë palë tjetër përveç Shoqërisë dhe AMF.

Raporte të tjera mbi Kërkesat e Kuadrit Rregullator

Drejtimi është gjithashtu përgjegjës për përgatitjen e anekseve shoqëruese suplementare të aftësisë Paguese dhe Aktivitet për Mbulimin e Detyrimeve të Sigurimit ("anekse shtesë") në përputhje me ligjin "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit". Bazuar në kërkesat e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në Shqipëri, ne kemi lexuar anekset suplementare shoqëruese. Këto anekse plotësuese të përgatitura nga drejtimi nuk janë pjesë e këtyre pasqyrave financiare për qëllime të veçanta. Informacioni historik financiar, i paraqitur në anekset shtesë të këtyre pasqyrave financiare për qëllime të veçanta, është në përputhje me informacionin vjetor financiar shpalosur në pasqyrat financiare për qëllime të veçanta të Shoqërisë më 31 dhjetor 2017, përgatitur në përputhje me kërkesat e raportimit financiar për Shoqëritë e Sigurimit në Shqipëri.

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri
30 prill 2018

Kledion Kodra, FCA
Kod



PASQYRE E HUMBJEVE DHE E TE ARDHURAVE TE TJERA PERMBLEDHESE TE INSIG SH.A.

(te gjitha shumat jane shprehur ne LEK,pervecse kur percaktohet ndryshe)

	Shenime	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Prime te shkruara bruto	29	1,086,216,196	1,071,860,283
Ndryshimi neto ne rezerven e primeve te pafituara	20	21,912,916	-245,904,792
Prime të shkruara neto		1,108,129,112	825,955,491
Prime te ceduara risiguruesve	30	-72,814,270	-106,300,026
Ndryshimi në rezerven e primeve të pafituara për pjesën e risiguruesit		-1,660,600	1,755,429
Prime të fituara neto		1,033,654,242	721,410,894
Të ardhura të tjera nga marrja në sigurim	31	11,999,320	6,328,459
Shpenzimet e demeve dhe te trajtimit te demeve	19	-264,726,318	-83,966,009
Shpenzimet e marrjes ne sigurim	32	-296,984,095	-117,257,285
Shpenzime administrative	33	-473,848,403	-444,707,360
Humbje operative		10,094,746	81,808,698
Të ardhurat financiare	35	69,208,056	33,628,565
Të ardhura/(humbje) nga kurset e këmbimit, neto	36	-49,945,601	-10,037,803
Të ardhura financiare neto		19,262,455	23,590,762
(Humbja)/fitimi para tatimit		29,357,201	105,399,461
Tatimi mbi fitimin	37	(6,321,833)	-13,346,818
Humbja e vitit		23,035,368	92,052,643
Të ardhura përmbledhëse të tjera			
Rezerva përkthimi			
Tatimi i shtyrë nga rezerva e katastrofës			
Totali i (humbjes)/të ardhurave përmbledhëse të vitit		23,035,368	92,052,643

Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Shënime	31 dhjetor 2017	Riparaqitur 31 dhjetor 2016	Riparaqitur 31 dhjetor 2015
AKTIVET				
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	8	8,527,109	21,261,959	65,687,043
Depozita me afat me bankat	9	382,826,914	53,824,227	652,415,716
Investime të mbajtura në maturim	10	-	1,241,849,465	1,521,755,613
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi dhe të tjera	11	46,501,261	61,043,957	38,321,956
Kosto të shtyra të marrjes në sigurim	12	214,756,267	156,747,648	54,881,653
Aktive të risigurimit	13	221,425,164	329,727,867	353,996,462
Të arkëtueshme nga risiguresit	14	-	135,731,877	2,759,127
Parapagim i tatimit mbi fitimin		28,941,556	58,443,528	17,559,225
Aktive të tjera	15	1,161,315,368	1,000,998,910	32,821,139
Aktive afatgjata materiale	16	425,266,398	138,474,215	127,869,508
Aktive afatgjata jo-materiale	17	4,608,673	5,421,968	4,248,284
Të drejta ndaj Eurosig AD		-	-	27,181,252
Marëdhënie me degën Insig Sh.a Kosovë	18	-	-	155,656,513
Pjesmarrje në shoqëri të kontrolluara	19	380,245,000	380,245,000	380,245,000
TOTALI I AKTIVEVE		2,874,413,710	3,583,770,621	3,435,398,491
DETYRIMET				
Detyrime për humbjet dhe shpenzimet e rregullimit të humbjeve	20	834,317,821	1,183,921,672	1,174,902,737
Rezerva për primet e paguara	21	551,652,540	658,370,987	412,466,195
Të pagueshme ndaj risiguresve	22	19,618,966	19,727,190	15,767,604
Detyrimet e qirasë	23	3,927,036	5,246,974	-
Hua Bankare	24	190,678,700	-	-
Llogari të tjera të pagueshme nga sigurimi	25	206,848,223	116,794,982	59,278,617
Provizione	26	360,860	6,996,678	11,810,859
Tatim i shtyrë		5,652,114	7,236,624	7,236,625
Të pagueshme ndaj shoqërive të kontrolluara		4,989,025	9,588,195	-
Marrëdhënie me degën Insig Sh.a Kosovë	18	670,856,947	940,139,709	-
TOTALI I DETYRIMEVE		2,488,902,232	2,948,023,011	1,681,462,637
KAPITALI				
Kapitali aksionar	27	650,000,000	1,020,000,000	1,020,000,000
Rezerva rivlerësimi	28	171,647,635	180,626,537	180,626,537
Rezervë për parandalimin e dëmeve	29	44,677,559	44,677,559	44,677,559
Rezerva të tjera	30	1,050,611,336	1,050,611,336	1,050,611,336
Rezerva nga kursi këmbimit		8,828,000	8,828,000	8,828,000
Fitimi i vitit		23,035,368	92,052,643	(20,848,653)
Humbje të mbartura		(1,563,288,420)	(1,761,048,465)	(529,958,925)
TOTALI I KAPITALIT		385,511,478	635,747,610	1,753,935,854
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		2,874,413,710	3,583,770,621	3,435,398,491

Këto pasqyra u miratuan nga Bordi Drejtues i Shoqërisë më 16 prill 2018 dhe u firmosën në emër të tij nga:

Znj. Venera Bica
Drejtor i Përgjithshëm (I komanduar)

Znj. Antoneta Mancellari
Drejtoresh e Departamentit të Finances

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 50, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare për qëllime të veçanta.

PASQYRE E KONSOLIDUAR E FLUKSIT TE PARASE 31 DHJETOR 2017

(te gjitha shumat jane shprehur ne LEK, pervecse kur percaktohet ndryshe)

Fluksi i parase nga aktivitetet operative	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Humbja pas tatimit	29,357,112	
Rregullime për:		-105,399,461
Zhvlerësimin	19,643,375	
Provigjon i llogarive te arketueshme dhe te tjera		10,645,851
Nxjerrja jashtë përdorimit	-694,964	10,976,918
Ndarje e fitimit te jete nga fitimet e mbartura	-16,644,821	159,195
Kthime te te drejtave tatimore	37,303,108	
Tatimi i shtyre per rivleresimin e asteve	-4,764,902	
Shpenzime interesi	9,396,914	
Të ardhura nga interesi	-8,808,376	-33,628,565
Fluksi i mjeteve monetare nga aktivitetet operative para ndryshimit në aktivet dhe detyrimet operative	64,787,446	93,552,860
<i>Ndryshimi në aktivet dhe detyrimet operative</i>	14,542,696	-33,698,920
<i>Ndryshimi në llogaritë e arkëtueshme të sigurimit dhe llogari të tjera të arkëtueshme</i>	-58,008,619	-101,865,995
<i>Ndryshimi në shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim</i>	108,302,703	24,268,595
<i>Ndryshimi në aktive të risiguruar</i>	135,731,877	-132,972,750
<i>Ndryshimi në detyrime të risiguruar</i>	-160,581,033	-978,177,771
<i>Ndryshimi në aktive të tjera</i>	-4,599,170	36,769,447
<i>Ndryshime ne te arketueshme per Shoqerite e kontrolluara</i>	-349,603,851	9,018,935
<i>Ndryshimi ne provigjionet e kontratave te sigurimit</i>	-106,718,447	245,904,792
<i>Ndryshimi ne rezervat e primit te pafituar</i>	-108,224	3,959,587
<i>Ndryshimi në detyrime ndaj risigurve</i>	-1,319,938	5,246,974
<i>Ndryshimi në detyrime per qera financiare</i>	90,053,241	64,544,642
<i>Ndryshimi në llogaritë e pagueshme</i>	-7,955,756	-4,814,182
<i>Ndryshimi në provigjionet e tjera</i>	-9,396,914	
<i>Interes i paguar</i>	-14,122,969	
<i>Tatimi mbi fitimin i paguar</i>		
Flukset monetare të gjeneruara / (të përdorura) nga aktivitetet operative	-298,996,958	-768,263,786
<i>Marredhenie me INSIG sh.a. Kosove</i>	-146,930,450	-175,507,721
<i>Blerje paisjesh dhe aktiveve jo materiale</i>	-372,397,987	-12,779,779
<i>Pakesime te aktiveve afatgjata</i>	63,256,691	
<i>Ndryshim në depozitat me afat</i>	-325,952,328	595,517,549
<i>Shitje/maturime te bonove të thesarit</i>	1,241,849,465	1,544,440,000
<i>Blerje te bonove te thesarit</i>		-1,248,310,000
<i>Interes i arektuar</i>	5,758,017	20,478,654
Flukset monetare të gjeneruara nga aktivitetet investuese	465,583,408	723,838,703
Flukset monetare nga aktivitetet financuese		

Disbursime te kredise bankare	202,500,000	
Shlyerje e kredise bankare	-11,821,300	
Pakesime kapitali	-370,000,000	
Flukset monetare të përdorura në aktivitetet financuese	-179,321,300	0
Ulje neto në mjetet monetare dhe ekuivalente me to	-12,734,850	-44,425,083
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fillim të vitit	21,261,959	65,687,042
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fund të vitit	8,527,109	21,261,959

SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

Më poshtë përfshihet një informacion përmbljedhës nga pasqyrat financiare të audituara

Deklaratë e përputhjes

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS), të përshtatura nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit

Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur në bazë të parimit të kostos historike, me përjashtim të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe investimeve të mbajtura për tregtim të cilat janë paraqitur me vlerën e drejtë.

Monedha funksionale dhe e prezantimit

Këto pasqyra financiare të konsoliduara janë të prezantuara në Lekë, monedha Shqiptare, që është dhe monedha funksionale e Grupit.

Baza e Konsolidimit

Filialet

Filialet janë ato entitete të cilat janë të kontrolluara nga Grupi. Kontrolli ekziston kur Grupi ka fuqinë, në mënyrë direkte dhe indirekte, të qeverisë politikën financiare dhe operative të një entiteti si dhe të sigurojë përfitime nga aktiviteti i tyre. Pasqyrat financiare të filialeve janë të përfshira në pasqyrat financiare të konsoliduara që nga data e fillimit të ushtrimit të kontrollit deri në datën kur ky kontroll mbaron.

Menaxhimi i Rrezikut Financiar

Shoqëria monitoron dhe menaxhon rrezikun financiar që lidhet me operacionet e saj përmes analizave të brendshme të riskut të cilat përshkruajnë shkallën dhe rëndësinë e riskut. Këto risqe përfshijnë riskun e tregut (risku i monedhës, risku i normave të interesit), riskun e kredisë dhe riskun e likuiditetit. Shoqëria nuk përdor instrumenta financiarë derivativë për t'u mbrojtur nga ekspozimi ndaj këtyre risqeve.

Risku i tregut

Risku i tregut është risku i një impakti financiar negativ si rrjedhojë e ndryshimeve të tregut të tilla si ndryshimet në kurset e këmbimit, në normat e interesit dhe ndryshime të tjera në çmime. Risqet e tregut krijohen për shkak të luhatjeve si në vlerën e aktiveve ashtu edhe të detyrimeve të mbajtura. Shoqëria ka përcaktuar politika dhe procedura për menaxhimin e riskut të tregut.

Risku i monedhës

Shoqëria ndërmerr transaksione si në monedhën lokale ashtu edhe në monedha të huaja; ndaj edhe lind rreziku prej luhatjes së kurseve të këmbimit. Për këtë arsye, luhatjet në kurset e

këmbimit të monedhave të huaja mund të ndikojnë nivelin e kapitalit të aksionerëve si rezultat kjo i përkthimit të tij në monedhën lokale. Risku i monedhës në portofolin e investimeve menaxhohet përmes përdorimit të parimit të përputhshmërisë së aktiveve me detyrimet.

Risku i kredisë

Risku i kredisë i referohet riskut që pala tjetër do të dështojë në obligimet e saj kontraktuale duke rezultuar në humbje financiare për Shoqërinë. Përgjatë kursit normal të biznesit, teksa arkëtohen primet, këto fonde investohen për të shlyer obligimet e ardhshme të policave. Shoqëria ekspozohet ndaj riskut të kredisë përmes titujve të borxhit të mbajtur deri në maturim, depozitave me afat, të arkëtueshmeve të sigurimit dhe kundërpartitë e risigurimit. Shoqëria ka vendosur procedura të brendshme dhe udhëzime sipas të cilave partnerët e risigurimit duhet të kenë vlerësime BBB- ose më të larta dhe të plotësojnë kërkesat e Shoqërisë përsa i përket kritereve për Risigurimet. Shoqëria menaxhon ekspozimin ndaj riskut të kredisë në mënyrë të rregullt përmes monitorimit të ekspozimit ndaj titujve të borxhit dhe kundërpartitë e depozitave me afat.

Analiza e sensitivitetit

Tabela e mëposhtme detajon sensitivitetin e Shoqërisë ndaj rritjes dhe uljes së Lekut përkundrejt monedhave të tjera relevante. Ky ndryshim në kurset e këmbimit përdoret kur bëhen raportimet e brendshme të riskut nga kurset e këmbimit për personelin e lartë menaxherial dhe përfaqëson vlerësimin e menaxhimit mbi ndryshimet e mundshme të kurseve të këmbimit valutor. Në cdo analizë sensitiviteti paraqitet ndikimi i ndryshimit të një faktori të vetëm, ndërsa faktorët e tjerë mbahen të pandryshuar, në analizën e sensitivitetit. Analiza e sensitivitetit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

		2017	2016
EUR rritet me 10 % kundrejt Lekut	Fitim	9,010,281	2,069,650
EUR bie me 10 % kundrejt Lekut	Humbje	(9,010,281)	(2,069,650)
USD rritet me 10 % kundrejt Lekut	Fitim	15,814,135	23,769,084
USD bie me 10 % kundrejt Lekut	Humbje	(15,814,135)	(23,769,084)
GBP rritet me 10 % kundrejt Lekut	Fitim	271,297	327,411
USD bie me 10 % kundrejt Lekut	Humbje	(271,297)	(327,411)

Rreziku i normës së interesit

Risku i normës së interesit përbëhet nga risku që vlera e flukseve të ardhshme monetare të një instrumenti financiar do të luhet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut dhe nga risku që maturitetet e aktiveve që mbartin interes do të ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve që mbartin interes dhe që janë përdorur për të financuar këto aktive. Kohëzgjatja brenda së cilës norma e interesit e një instrumenti financiar qëndron e fiksuar përcakton edhe shkallën e riskut të normës së interesit ndaj të cilit ekspozohet instrumenti. Më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 Shoqëria nuk ka pasur detyrime të rëndësishme interesmbajtëse dhe as instrumenta me norma të ndryshueshme, por përqendrimin më të madh të rrezikut të normës së interesit e ka lidhur me depozitat me afat dhe bonot e thesarit, të cilat kanë maturitet 1 deri në 2 vjet.

Risku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria nuk do të përmbushë obligimet e saj që lidhen me detyrime financiare brenda periudhës kur duhet të shlyhen. Risku i likuiditetit është një risk i moderuar i brendshëm për aktivitetin e biznesit të Shoqërisë sepse disa prej aktiveve të blera dhe detyrimeve të shitura mund të kenë karakteristika likuiditeti që janë specifike. Nëse Shoqëria do të kërkonte shumën të konsiderueshme brenda një periudhe të shkurtër duke tejkalluar kërkesat normale për mjete monetare, ajo mund të përballej me vështirësi për të siguruar çmime tërheqëse. Pavarësisht kësaj, Shoqëria ka akses në huamarrje më 31 dhjetor 2017 dhe 2016. Shoqëria administron riskun e likuiditetit përmes monitorimit të vazhdueshëm të fluksit të parasë të parashikuar dhe atij aktual, duke përputhur maturitetet e aktiveve dhe detyrimeve financiare.

Supozime dhe sensitiviteti

Rreziqet e lidhura me kontratat e sigurimit të jo-jetës janë komplekse dhe subjekt i një numri variablash që e komplikojnë analizën kuantitative të sensitivitetit. Shoqëria përdor teknika statistikore dhe aktuariale duke përfshirë treguesë të tillë si raporti i humbjes së pritur. Grupi e konsideron si të mjaftueshëm detyrimin për dëmet e jo-jetës në sigurim që njihen në pasqyrat e pozicionit financiar. Megjithatë, përvoja aktuale do të ndryshojë nga rezultati i pritur.

Rezultatet e analizës së sensitivitetit që tregojnë impaktin mbi fitimin përpara tatimit paraqiten më poshtë. Për këtë lloj sensitiviteti tregohet impakti i një ndryshimi në një faktor të vetëm, duke mbajtur supozimet e tjera të pandryshuara (në '000 Lek):

Raporti i dëmeve

Impakti 2017 2016

5 % rritje në raportin e dëmeve	Humbje	(13,236,316)	(4,198,300)
5 % rënie në raportin e dëmeve	Fitim	13,236,316	4,198,300

Raporti i shpenzimeve

5% rritje në raportin e shpenzimeve	Humbje	(23,692,420)	(28,098,232)
5% rënie në raportin e shpenzimeve	Fitim	23,692,420	28,098,232

Raporti i kombinuar

5 % rritje në raportin e kombinuar	Humbje	(36,928,736)	(32,296,533)
5 % rënie në raportin e kombinuar	Fitim	36,928,736	32,296,533

Treguesit e mjaftueshmerise se kapitalit, treguesit e likuiditetit dhe treguesit e aktiveve ne mbulim te provigjoneve teknike

- Vlerat për treguesit e mjaftueshmërisë se kapitalit dhe treguesit të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike mund ti konsultoni në Raportin e Shoqërisë audituese mbi pasqyrat financiare 2017, të përgatitur sipas SNRF (pjesë e këtij raporti fq.15).Sa l takon treguesit të likuiditetit shoqëria disponon likuiditete të mjaftueshme për të përmbushur obligimet e saj që lidhen me detyrimet financiare brenda periudhës kur duhet të shlyhen referuar detajeve në Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare 2017.

RAPORT (Përmbledhje)

Mbi Veprimtarinë e Auditimit të Brendshëm në shoqërinë INSIG sha për Vitin 2017.

I. Veprimtaria e AB në shoqërinë INSIG sha.

- Veprimtaria e AB është përshtatur dhe funksionon sipa kërkesave ligjore.
- Veprimtaria e Auditimit të Brendshëm për vitin 2017 është ushtruar mbështetur në Planin vjetor të auditimeve të vitit 2017, miratuar nga Komiteti i Auditimit dhe Këshilli Mbikëqyrës me vendim nr. 14 datë 23 dhjetor 2016.
- Për vitin 2017 janë realizuar gjithsej 21 misione auditimi dhe janë dhënë për zbatim 140 rekomandime të miratuara nga KM.
- Në zbatim të kërkesave ligjore dhe rregulloreve në fuqi raportet e auditimit dhe rekomandimet janë shqyrtuar dhe miratuar nga Komiteti i Auditimit dhe Këshilli Mbikëqyrës. Kjo formë raportimi dhe miratimi, ka rritur pavarësinë funksionale të njësisë së auditimit dhe cilësinë e rekomandimeve .

Njësia e AB ka realizuar objektivat dhe planin vjetor të auditimeve për vitin 2017 të miratuara nga KM. Gjetjet dhe problematikat e konstatuara gjatë auditimeve janë adresuar sipas degëve dhe Departamenteve përkatëse, është kërkuar nxjerrja e përgjegjësive dhe janë dhënë rekomandimet për përmirësimin e gjendjes, këto të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës.

II. Konstatimet dhe gjetje nga auditimi i brendshëm për vitin 2017 :

Konkluzione të Përgjithshme:

- Strukturat e shoqërisë INSIG sha, rrjeti i shitjes, Degët dhe Departamentet gjatë vitit 2017, në përgjithësi kanë ushtruar veprimtarinë në përputhje me kornizën ligjore si të Ligjit të Sigurimeve dhe Risigurimeve dhe rregulloreve të AMF (Marrja në Sigurim, Trajtimi dëmeve, menaxhimi i rrisqeve,etj)
- Strukturat përkatëse si Degët dhe Departamentet në përgjithësi kanë angazhimin dhe përgjegjësinë për zbatimin e politikave të aksionarit, të rregulloreve të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës si dhe udhëzimeve dhe urdhrave të menaxhmentit të kompanisë.
- Në disa raste janë konstatuar mangësi në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm pasi mungon harmonizimi dhe rakordimi midis Degëve dhe Departamenteve dhe midis vete Departamenteve, kjo ndikon në mos funksionimin sa duhet të niveleve të verifikimit ,

autorizimit dhe rakordimit te shitjeve, dëmeve ,raportimeve, etj.

- Konstatimi në kohë i problematikave dhe zbatimi i rekomandimeve të AB për eliminimin e mangësive, ka ndikuar në parandalimin e parregullsive në zbatimin e sistemit tarifar, administrimin e rrjetit të shitjes, administrimin e policave, menaxhimin e shpenzimeve, etj.

1. Konstatime në Auditimin e veprimtarisë së Rrjetit të shitjes / Degëve .

- Në zbatim të rekomandimeve të AB është unifikuar struktura organizative e degëve me specialist finance dhe të administrimit të policave (kjo në vartësi dhe të volumit të shitjeve të degës).
- Ka funksionuar procesi i rakordimeve mujore të degëve me departamentet në qendër, për dorëzimin e policave, pagesat e komisioneve, etj.
- Për marrjen në sigurim janë zbatuar udhëzimet, rregulloret dhe kushtet e përgjithshme për sigurimet motorrike, TPL, Kartoni Jeshil dhe Kufitare, pasuri, etj.
- Të gjitha policat shiten në sistemin on-line duke rritur saktësinë e marrjes në sigurim, pasi janë të disiplinuar kategoritë e mjeteve, tarifat, nivelet e marrjes në sigurim, etj.
- Gjendja fizike e policave në rrjet verifikohet me sistemin e shitjes. Anullimet, dublikatat, kthimet, etj. realizohen vetëm nëpërmjet sistemit të shitjes. Në disa raste nuk respektohet afati i dorëzimit të policave në qendër.
- Është rekomanduar, që të bëhen ndryshime në kontratën e agjentit/punonjësit, ku të parashikohen penaltete në rastet e shitjes jashtë sistemit, shitjes me nënagjent, humbjen e policave, mos arkëtimin e primit , etj.

2. Vlerësimi i sistemit të trajtimit të Dëmeve

- Departamenti i dëmeve ka ushtruar veprimtarinë në mbështetje të legjislacionit dhe rregulloreve të brendshme të kompanisë si në trajtimin e dëmit dhe pagesave brenda afateve ligjore.
- Është rekomanduar që të bëhen qartësime në rregulloren e brendshme të trajtimit të dëmeve, në disa drejtime: Skema e asistencës ndaj klientit për veprimet që duhet të kryejnë në vendngjarje, procedura e hapjes së praktikës së dëmit, plotësimit të dokumentacionit, etj.
- Janë konstatuar disa parregullsi në trajtimin e dëmeve kasko si rrjedhojë e paqartësive në kushtet e përgjithshme të marrjes në sigurim.
- Janë zgjidhur disa paqartësi në përcaktimin e shkallës së paaftësisë në punë si në raport me KMCAP dhe vlerësimeve nga GES.

3. Vlerësimi i sistemit të financës

- Zbatimi i rekomandimeve të AB, ka ndikuar në përmirësimin dhe rregullimin e disa problematikave në sistemin e Kontabilitetit, si: Miratimin dhe zbatimin e afateve kohore për regjistrimin e dokumentacionit kontabël në programin financiar (deri me 10 të çdo muaji), rakordimin me degët (deri date 13 të çdo muaji), menaxhimin e zërave të shpenzimeve, kryesisht shpenzimet administrative.
- Janë nxjerrë dhe raportuar brenda afateve ligjore bilancet financiare dhe raportet që kërkohen nga autoritet drejtuese të kompanisë dhe AMF.

4.Vlerësimi i sistemit të marrjes në sigurim

- Për produktet Kasko dhe Pasuri në programin e shitjes është qendëruar sistemi tarifar, fotot e objektit, pyetësorët dhe kufizimi sipas nivelit autorizues të shumës së siguruar, etj., kjo ka minimizuar rrishtet operacionale dhe të mashtimit të marrjes në sigurim.
- Janë zbatuar procedurat e administrimit të policave dhe rakordimit me rrjetin e shitjes që nga momenti i furnizimit, shitjes dhe dorëzimit në Departamentin e Marrjes në Sigurim të policave. Kjo skemë është rregulluar me udhëzim të veçantë.
- Është realizuar rregullimi dhe kufizimi me nivel kompetencash në sistemin e shitjes në mënyrë të tillë që për produktet Vullnetare të ketë kufizim në shitjen e tyre, me miratim nga Drejtoria Qendrore, kjo me qëllim mbrojtjen nga rishtet e marrjes në sigurim.
- Është rregulluar skema e miratimit, regjistrimit dhe pagesave të komisioneve të agjentit.
- Për disa produkte është rekomanduar dhe po bëhen përmirësime në kushtet e përgjithshme dhe udhëzimet e marrjes në sigurim.

5. Vlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm (Departamente dhe struktura të tjera)

- INSIG rregulla dhe procedura korrekte të miratuara lidhur me sigurimin e cilësisë së operacioneve të veprimtarisë së INSIG. Ka procedura dhe rregullore të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës, lidhur me identifikimin, matjen dhe monitorimin e nivelit të rreziqeve si dhe parandalimin dhe administrimin efektiv të tyre.
- Në rregulloret e miratuara por dhe në zbatimin praktik në përgjithësi ka ndarje funksionesh për verifikimin, kontrollin, autorizimin e operacioneve në marrjen në sigurim, të trajtimit të dëmeve, të kryerjes së pagesave, etj.
- Sistemi i pagesave që nga kontrolli i faturave, verifikimi nga departamentet operacionale, verifikimi nga departamenti i financës dhe urdhër pagesa me dy firma të autorizuar, kanë rritur nivelin e kontrollit të pagesave.
- Por është konstatuar se në disa raste kërkohet një harmonizim dhe koordinim më efikas midis degëve me departamentet përkatëse por dhe midis departamenteve me qëllim që çdo veprimtari dhe veprim të jetë i kontrolluar dhe i monitoruar në kohë (paraprakisht) dhe jo pas kryerjes së veprimit.
- Auditimi i brendshëm për çdo subjekt të audituar (departamente dege, etj.) ka vlerësuar se si ka funksionuar sistemi i kontrollit të brendshëm si dhe ka dhënë rekomandimet përkatëse.

III. Plani e Auditimit dhe Prioritet për vitin 2018:

- Plani i auditimit për vitin 2018 është miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 8, datë 15 nëntor 2018.
- Gjithsej do kryhen 19 auditime (Departamente, Dege, Zyra Përfaqësimi, etj.).
- Niveli i vlerësimit të riskut për 19 objektet që auditohen është:
 - objekte dhe fusha me risk të lartë 6
 - me risk të mesëm 13 objekte.

Raporti "Mbi Veprimtarinë e Auditimit të Brendshëm në shoqërinë INSIG sha për Vitin 2017" është miratuar nga Komiteti i Auditimit dhe nga Këshilli Mbikëqyrës dhe sipas kërkesave ligjore është depozituar brenda afatit ligjor edhe ne Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.